

KARTËMONEDHA 200 LEKË

KONTROLLO VËRTETËSINË E KARTËMONEDHËS

PREK

Kjo kartëmonedhë është prodhuar prej materiali polimer, një përbërje plastike, që të jep një ndjesi të veçantë në prekje


- 1 Ndieje shtypin e ngritur te numrat, shkronjat, portreti si dhe vijat e shkurtra përgjatë skajit të majtë dhe të djathtë të kartëmonedhës, që përbëjnë dhe elementin e njohjes së kartëmonedhës nga të verbrit

SHIKO

- 2 Një dritare e tejkushme shfaq portretin e kartëmonedhës, vlerën 200 Lekë dhe kolonadën e ndërtesës së Bankës së Shqipërisë
- 3 Një figurë e stilizuar e shqiponjës ndodhet në të dy anët e kartëmonedhës. Të dy figurat duhet të përputhen plotësisht njëra mbi tjetrën

LËVIZ

- 4 Shiriti i shndritshëm në zonën qendrore shfaq të shkruar vlerën 200 Lekë



KARTËMONEDHA JONË E RE: E SIGURT DHE MODERNE

Banka e Shqipërisë emeton serinë e re të kartëmonedhave shqiptare, me pamje e cilësi të përmirësuar, për t'iu përshtatur zhvillimeve të teknologjisë, duke i bërë ato më të sigurta dhe të besueshme për publikun.

Kartëmonedhat ekzistuese do të vijojnë të përdoren si mjet pagese bashkë me kartëmonedhat e reja.

